REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 8896 Prot.

Tiranë, më 02.11.2015

**UDHËZIM**

Nr. 49, datë 02.11.2015

**PËR**

**"KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE TË REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT ME STATUSIN E ISH - TË DËNUARIT DHE TË PËRNDJEKURIT POLITIK NGA SISTEMI KOMUNIST, TË VERBRIT, TË INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, TË JETIMIT, SI DHE ROMËT DHE BALLKANO-EGJIPTIANËT, PËR PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE"/"MASTER I ARTEVE TË BUKURA", PËR VITIN AKADEMIK 2015 – 2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve nr. 26 dhe 34 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 135 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 – 2016", i ndryshuar,,

**UDHËZOJ**:

I. Kandidatët me statusin e ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politik, të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, aplikojnë direkt në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), nga data 02 deri më 09 Nëntor 2015.
Kandidatët shprehin 5 preferenca të ndryshme lidhur me aplikimin në programet e preferuara të studimit sipas formularit në Shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

II. Aplikimi bëhet duke dorëzuar në MAS, personalisht, dokumentacionin e mëposhtëm në dy kopje:

1. Për të gjithë kandidatët:

a) Letër motivimi ku të shpjegojë arsyet e aplikimit si dhe të zgjedhjes së programeve të studimit të përcaktuara në formular prej tij;

b) Formulari i aplikimit sipas formatit të Shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në formular duhen radhitur pesë programe studimi ku kandidati kërkon të aplikojë, si dhe Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) përkatës, në renditje prioritare, pra i pari renditet programi më i preferuar dhe i fundit ai më pak i preferuar nga të pesta programet. Për emërtimin dhe ID e programit përkatës i duhet referuar Tabelave nr. 1/1 dhe 2/2 të Vendimit nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 – 2016", i ndryshuar.

c) Diplomë universitare e ciklit të parë të studimeve të përfunduar brenda Republikës së Shqipërisë, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Në mungesë të diplomës IAL-të publike pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimevesi dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetimin në IAL-në ku kërkon të regjistrohet sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të kartonit të diplomës të lëshuar nga IAL-ja përkatëse. Për diplomën universitare të ciklit të parë të fituar jashtë vendit, të depozitohet dhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për kandidatët të cilët nuk kanë njësuar diplomat e tyre të fituara jashtë vendit, depozitojnë dokumentacionin për njësim diplome në të njëjtën ditë me aplikimin.

d) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga MAS. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme, së bashku me vërtetimin nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) për shlyerjen e provimeve me zgjedhje, nëse kanë dhënë provime të tilla. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore dhe provimesh me zgjedhje (nëse kanë dhënë provime të tilla) të lëshuar nga AKP, ose dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në njësinë arsimore vendore ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Dy fotografi personale.

2. Kandidati me statusin e ish- të dënuarit dhe të përndjekurit politik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën "1" duhet të dorëzojë:

   a. për ish- të dënuarit fotokopjen e njësuar në Republikën e Shqipërisë të dokumentit që vërteton statusin e ish- të dënuarit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

   b. për ish- të përndjekurit politikë fotokopjen e njësuar në Republikën e Shqipërisë të dokumentit që vërteton statusin e ish- të përndjekurit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme;

3. Kandidati me statusin e të verbrit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën "1" duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

4. Kandidati me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1) duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e librezës së invalidit paraplegjik e tetraplegjik të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP.

5. Kandidati me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën "1" duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që çertifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

6. Kandidati Rom dhe Ballkano-Egjiptian, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën "1" duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.

III. Komisioni i posaçëm, i përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e kryetarit, dhe 4 anëtarë, nga të cilët dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe dy përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shqyrton dhe vlerëson aplikimet e kandidatëve me statusin përkatës brenda datës 16 Nëntor 2015. Pjesë e vlerësimit të jetë dhe intervista me secilin kandidat, që zhvillohet nga Komisioni i Posaçëm. Aplikimet me dokumentacion të paplotë nuk merren në konsideratë. Vlerësimi të bëhet mbi kriterin e meritës, bazuar në notën mesatare të të gjitha viteve të studimeve universitare të ciklit të parë, si dhe eventualisht në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme, duke vlerësuar dhe programet që gjykohet të jenë prioritare sipas propozimeve të autoriteteve të vendeve përkatëse, si dhe duke marrë parasysh kapacitetet pritëse të çdo IAL-je për programin përkatës të studimit. Nëse, do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, do t'i nënshtrohen testimit që do të kryhet nga MAS.

IV. Brenda datës 20 Nëntor 2015 MAS përcjell në IAL-të respektive listën e renditur të kandidatëve të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme dhe një kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, për të vijuar me regjistrimin e kandidatëve në programet përkatëse të studimit. MAS publikon në faqen web listën e kandidateve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatëse.

V. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës 27 Nëntor 2015.

VI. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP brenda datës 30 Nëntor 2015 listat përfundimtare të përgatitura sipas formatit të dërguar nga AKP, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për dhënien e numrave të matrikullimit, në formë të shkruar dhe elektronike.

VII. AKP brenda datës 29 Dhjetor 2015 i dërgon IAL-ve publike në rrugë postare, listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të publike çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi, dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP me listat me numrat e matrikullimit.

VIII. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Komisioni i Posaçëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në "Fletoren Zyrtare".

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

**SHTOJCA nr. 1** Tiranë, më ____/____/2015

**Formular aplikimi**

Unë i nënshkruari ______________________________, lindur më _______________

emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. ______________________

e-mail: ________________________, Tel: ________________________

1. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit:
   a. __________________________, ID____, në IAL __________________________,
   ose
   b. __________________________, ID____, në IAL __________________________,
   ose
   c. __________________________, ID____, në IAL __________________________,
   ose
   d. __________________________, ID____, në IAL __________________________,
   ose
   e. __________________________, ID____, në IAL
   __________________________.

2. Deklaroj se jam (të shenohet me "x" kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):

   □ i/e verbër;
   □ invalid paraplegjik / tetraplegjik;
   □ jetim;
   □ Rom;
   □ Ballkano-Egjiptian.

3. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
   Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, aplikimin, si dhe të dhënat e deklaruara në këtë formular.

4. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e

programit të studimit ku po aplikoj. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, për programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i arteve të bukura", për vitin akademik 2015 – 2016" dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

| | |
|---|---|
| Emër Atësi Mbiemër<br>i kandidatit | Emër Mbiemër<br>i punonjësit që pranoi aplikimin |
| Firma | Firma |